

I nderuar z. Braçe, Kryetar i Komisionit

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj Deputetë, anëtarë të Komisionit

I nderuar z. Ministër,

Duam të shprehim mirënjohjen tonë për mbështetjen e vazhdueshme dhe të çmuar që ky Komision, dhe në veçanti Kryetari, i ka dhënë institucionit të LSH-së për të përmbushur me sukses misionin e vetë kushtetues për mbikëqyrjen e jashtme efektive të financave publike, në shërbim të qytetarit dhe të Kuvendit.

Gjithashtu falënderojmë Ministrin e Financave dhe Ekonomisë për bashkëpunimin e ofruar gjatë auditimeve tona për Buxhetin e vitit 2016.

KLSH i ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë “Raportin për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2016” dhe, në vijim, ju paraqes një përmbledhje të tij dhe opinionin tonë si auditues i jashtëm publik.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, si institucion i pavarur kushtetues, në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Ligjit 154/2014 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” ka përgatitur dhe paraqitur raportin “Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2016”, me fokus dhënien e opinionit mbi raportin që Këshilli i Ministrave paraqet në Kuvend “*Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2016*” dhe propozimin e projekligjit “*Për miratimin e buxhetit faktik të shtetit për vitin 2016*”, të depozituar pranë KLSH-së. Ky raport përgatitur në referencë me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI), duke analizuar zbatueshmërinë e Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 62 e 63, si dhe të Ligjit nr. 147/2015, datë 17.12.2015, “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2016”, i ndryshuar.

KLSH, ka arritur në Opinionin e Përgjithshëm se “Zbatimi i Buxhetit të Shtetit për vitin 2016, duke nisur nga përgatitja, shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit të vitit 2016, zbatimi, ndjekja dhe rishikimi i tij, të drejtat dhe kufizimet për huamarrjen, garancitë dhe format e tjera të rrjedhura prej tyre si dhe kontrolli, kontabiliteti, raportimi dhe auditimi i këtij buxheti, në terma proceduralë respektojnë kërkesat e ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit “Për buxhetin e shtetit të vitit 2016”, të ndryshuar, si dhe të ligjit “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Kemi konstatuar aspekte mbi të cilat ne shprehim rezervat tona lidhur me paraqitjen e disa treguesve fiskalë të vitit 2016, por që në përfundim nuk mendojmë se çënojnë tërësinë e shifrave të buxhetit faktik të vitit 2016. Monitorimi i indikatorëve të performancës së financave publike sipas shtyllave prioritare të planifikuara në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, tregon një përpjekje pozitive të Ministrisë së Financave, por konsolidimi i mëtejshëm i kësaj praktike kërkon rishikimin e disa indikatorëve, pasi për shkak të metodologjisë së matjes, disa indikatorë nuk reflektojnë performancën reale të financave publike.

Në këtë raport KLSH, në funksion të mbikëqyrjes së jashtme efektive të financave publike (Shtylla e Gjashtë e Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020), adreson problematikat e konstatuara gjatë planifikimit, administrimit dhe raportimit të zërave të Buxhetit të vitit 2016, si dhe jep rekomandime për aspektet më kryesore të ciklit buxhetor. Rekomandimet nga ana tjetër synojnë një sistem të integruar dhe funksional të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe struktura të auditimit të brendshëm eficiente dhe në funksion mbështetës dhe këshillimor për strukturat e ngarkuara me përgjegjësi menaxheriale. Gjetjet dhe konstatimet janë rezultat i punës audituese në 106 subjekte, institucione qendrore dhe vendore, realizuar përgjatë 3 mujorit të fundit të vitit 2016 dhe 9 mujorit të vitit 2017.

Nëpërmjet këtij Raporti, KLSH-ja sjell në vëmendje një sërë rekomandimesh që synojnë konsolidimin e financave publike.

Më konkretisht:

MBI PROGRAMIMI BUXHETOR AFATMESËM (PBA) DHE VJETOR

Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal (KMF) dhe ai i rishikuari, shërbejnë si pikënisje për përcaktimin e taveve për të filluar procesin e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm. Në gjykimin tonë të pavaruar profesional *programimi i të ardhurave dhe parashikimi i treguesve ekonomik mbeten pika më e dobët e ciklit buxhetor, që shoqërohet më pas me rishikimin e nivelit të shpenzimeve. Kuadri makroekonomik dhe fiskal i përshtatet ndryshimeve buxhetore, dhe për rrjedhojë humbet rolin e të qenit mjet strategjik, dhe pikë reference për Programimin Buxhetor Afatmesëm dhe vjetor. Sikurse është evidentuar në mënyrë të detajuar në raportin e KLSH-së, është evidentuar praktika e plotësimit të Programit Buxhetor Afatmesëm në mënyrë formale, me cënime të standardeve dhe saktësisë së programimit të produkteve. Me këto kushte Programi Buxhetor Afatmesëm nuk mund të realizojë qëllimin, lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet prioriteteve ekonomike të Qeverisë me shpërndarjen e burimeve dhe kryerjen e shpenzimeve publike, promovimin e disiplinës fiskale, si dhe nuk mundëson programim të shpenzimeve publike brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal.*


Me miratimin e Ligjit nr. 147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016” në datë 17.12.2015, treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve rezultojnë në nivele më të ulta se ata të miratuara në kuadrin afatmesëm 2016-2018.

- Të ardhurat totale të programuara janë ulur me 5.5% krahasuar me fazën e parë të PBA 2016-2018.
- Shpenzimet e programuara janë ulur me 6.3% krahasuar me fazën e parë të PBA.

Gjithashtu, KLSH vëren se programi buxhetor vijoi të preket nga ndryshimet e buxhetit me Akte Normative, praktikë që gjatë viteve të fundit është një praktikë e konsoliduar, duke cënuar kredibilitetin e Buxhetit të Shtetit. Rishikimi i treguesve të parashikuar me Ligjin nr.147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, me dy akte normative, është fakt që tregon se zërat e shpenzimeve dhe të të ardhurave janë programuar mbi baza jo realiste, për të mos thënë tejet optimiste për të ardhurat, e shoqëruar me një proces jo të kujdesshëm dhe të pa monitoruar nga strukturat respektive që janë përgjegjëse për realizimin e tyre. Akti i fundit normativ lidhur me buxhetin është propozuar nga qeveria në ditët e fundit të muajit dhjetor 2016 (miratuar nga Kuvendi në janar 2017).


Grafiku: Dinamika e programimit të të ardhurave për vitin 2016 (sipas fazave të planifikimit dhe fakti)

Në milionë lekë



Burimi. Ministria e Financave, përpunuar nga grupi i auditimit

Grafiku: Dinamika e programimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2016 (sipas fazave të planifikimit dhe fakti)



Burimi. Ministria e Financave, përpunuar nga grupi i auditimit

KLSH, konstaton se, ndryshe nga sa angazhuar në Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020, parashikimet tejet optimiste mbi të ardhurat dhe PBB-në kanë vazhduar të ndikojnë ndjeshëm proceset e buxhetimit dhe planifikimit gjatë vitit të fundit. KLSH vlerëson se përmbushja e synimeve të strategjisë kërkon një angazhim gjithëpërfshirës dhe nuk është përgjegjësi vetëm e Ministrisë dhe e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilët koordinojnë këtë proces.

Përsa më sipër kemi rekomanduar:

- Krijimin e menjëhershëm të **Këshillit Fiskal** (rekomandim i dhënë edhe më parë, në Raportin për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2013, përsëritur si kërkesë prioritare në Raportin e Zbatimit të Buxhetit 2015), si një autoritet i cili duhet të mbikqyrë përputhshmërinë me rregullat fiskale, monitorojë konsolidimin fiskal, përfshirë saktësinë e parashikimeve makroekonomike, cilësinë e planifikimit buxhetor afatmesëm, si dhe të japë rekomandime që lidhen me qëndrueshmërinë fiskale dhe makroekonomike.
- Përzgjedhja e këtij Këshilli t'i largohet praktikave formale të konstatuara gjatë konstituimit të bordeve të ngjashme, ndërkohë që gjykojmë se kriteret e përzgjedhjes së personave duhet të jenë të larta referuar kapacitetit profesional dhe integritetit personal, ku kusht me rëndësi është përvoja e konsoliduar në menaxhimin e financave publike.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, së bashku me dokumentet e buxhetimit afatmesëm, të publikojë edhe analiza sasiore dhe faktoriale, për ndikimet që kanë shkaktuar ndryshimet mes parashikimeve. Një Program Buxhetor Afatmesëm i hartuar saktë nga institucionet buxhetore do të sjellë jo vetëm konsolidimin e procesit buxhetor afatmesëm, por gjithashtu do të disiplinojë edhe parashikimin e detyrimeve kontraktuale me efekt financiar përtej vitit buxhetor. Në terma vjetorë të publikohen shpjegimet dhe burimet e variancave në planifikim, me qëllim rritjen e cilësisë së

parashikimit dhe gabimeve që duhen shmangur në vijim. Kjo do të sjellë hartimin më të shpejtë të buxheteve kredibël.

MBI TREGUESIT E KONSOLIDUAR FISKALË TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITIN 2016

A. TË ARDHURAT E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT TË SHTETIT.

Megjithëse të ardhurat e përgjithëshme të vitit 2016 rezultojnë me rritje për 7.4% kundrejt vitit 2015, për vitin 2016, të ardhurat janë realizuar **97.19% ose** 11,791 milionë (11.7 miliardë) lekë më pak kundrejt programimit fillestar, ndërsa po të krahasohet me planin e rishikuar niveli i realizimit është 98.2%. Mosrealizimi i të ardhurave ka ardhur kryesisht nga të ardhurat tatimore. *Nga auditimi u konstatuan pasaktësi në shumën e të ardhurës së deklaruar si tatim fitimi, pasi nuk është korriguar shifra e parapagimeve të tatim fitimit, me vlerën reale të të ardhurës që i takon Buxhetit të Shtetit për vitin 2016. Niveli i gabimit i konstatuar nuk e kalon pragun e riskut për të cilin KLSH, modifikon opinionin e saj.*

Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020 cilëson se do të vazhdojnë përpjekjet për të forcuar menaxhimin e të ardhurave, duke rishikuar politikën e taksave dhe reformuar administratat tatimore dhe doganore, për të rritur eficiencën e tyre në mbledhjen e të ardhurave dhe zvogëluar hendekun tatimor. Në të, qeveria është angazhuar që të përmirësojë menaxhimin e borxhit tatimor dhe doganor.

Në lidhje me këtë angazhim, KLSH ka konstatuar se të ardhurat e munguara në buxhetin e shtetit si rezultat i rritjes së detyrimeve që subjektet kanë për t'i paguar administratës tatimore dhe doganore është një nga faktor i rëndësishëm që ka ndikuar në performancën fiskalë të vitit raportues. Përveç rritjes së Borxhit Tatimor dhe Doganor në vlerë nominale me 41.1% në krahasim me 2015, rezulton se pesha e këtij borxhi si përqindje ndaj PBB-së, nga 8.5% e PBB-së në fund të 2015 ka arritur në 11.7% e PBB-së në fund të 2016. KLSH


shprehet, me shqetësim, se stoku i borxhit tatimor është i përqendruar, ku 1.4% e numrit total të subjekteve zënë 77% të stokut të borxhit. Në fund të vitit 2016, detyrimet tatimore të subjekteve buxhetore dhe enteve publike zënë 17% të totalit të stokut të borxhit.

Nga auditimi i Borxhit Tatimor dhe analiza e të dhënave rezultoi se kemi një rritje me shifra alarmante të këtij borxhi për vitin 2016 (përfshi këtu dhe borxhin e raportuar nga DPT në lidhje me sigurimet shoqërore në vlerë 14,131 milionë lekë), i cili në fund të vitit arriti në masën 147,068 milionë lekë. Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, gjatë vitit 2016 vlera e borxhit është rritur për shumën 46,695 milionë lekë ose 46.5% të gjendjes së borxhit në fillim të vitit 2016. Ndërkohë që numri i subjekteve debitorë në fund të vitit 2016 është 146 650, me një rritje prej 63 366 subjektsh në krahasim me një vit më parë. Në ndarjen e stokut të borxhit sipas madhësisë, në fund të vitit 2016 subjektet me borxh më të madh se 5,000 mijë lekë (2 067 subjekte ose 1.4% e numrit total të subjekteve) zënë 77% të stokut të borxhit ose 113,766 milionë lekë në total. Në fund të vitit 2016, detyrimet e subjekteve buxhetore dhe enteve publike zënë 17% të totalit të stokut të borxhit.

Nga auditimi i Borxhit Doganor, në fund të vitit 2016 rezultojnë gjithsej 4 704 raste subjekte debitorë në shumën 24,788 milionë lekë, nga të cilat 6,751 milion lekë si detyrim doganor, 15,135 milionë lekë në formën e gjobës doganore dhe 2,902 milionë lekë në formën e kamatëvonesave. Në fund të vitit 2015 rezultojnë gjithsej 4 798 raste subjektsh debitorë për një vlerën totale 21,457 milionë lekë, nga të cilat 6,597 milionë lekë për detyrime doganore, 12,504 milionë lekë në formën e gjobës doganore dhe 2,356 milionë lekë në formën e kamatëvonesave. Borxhi Doganor dhe borxhi i akcizës gjatë vitit 2016 rezulton me një ulje të lehtë të numrit të rasteve (94 raste më pak), por me një rritje të vlerës së borxhit të përgjithshëm me 3,331 milionë lekë ose 15.5%.

Dinamika e të ardhurave buxhetore në harkun kohor 2011-2016, jepet në grafik, ku vihet re rritja e lehtë e të ardhurave për vitin buxhetor 2016.

Në milionë lekë




Burimi. Ministria e Financave, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi i përputhshmërisë së aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me ligjet, rregulloret, politikat dhe kodet e vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u konstatuan devijime materiale, duke justifikuar dhënien e një opinioni të kualifikuar.

B. SHPENZIMET E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT TË SHTETIT.

Shpenzimet buxhetore për vitin 2016 janë realizuar më pak se viti 2015 me 3,635 milionë (3.6 miliardë) lekë dhe janë realizuar **95.7%** krahasuar me planifikimin fillestar. Impaktin më të madh në këtë rënie e ka mosrealizimi i shpenzimeve për interesa si dhe shpenzimet për buxhetin vendor. Mosrealizimi i të ardhurave, niveli i treguesve makroekonomik, ka ndikuar në nën realizimin e planit të shpenzimeve për vitin 2016. Dinamika e shpenzimeve faktike të buxhetit të shtetit në harkun kohor të viteve 2011-2016, jepet në grafikun e mëposhtëm, ku vihet re se shpenzimet e përgjithshme janë më të ulta se viti 2015 dhe 2014.

Në milionë lekë




Burimi. Ministria e Financave, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga analiza e strukturës së buxhetit faktik, konstatohet se 85% e shpenzimeve buxhetore janë **shpenzime korrente**. Referuar nivelit të progamuar, shpenzimet korrente janë realizuar në masën 95.7%. Sjellim në vëmendje që shpenzimet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, për largim nga puna, **vetëm** për vitin 2016, kapin vlerën 1,521 milion (1.5 miliardë) lekë, çka nënkupton kujdesin që duhet treguar për largimet nga puna në administratën shtetërore.

Në lidhje me shpenzimet e buxhetit të pushtetit vendor, KLSH sjell në vëmendje se mungesa e performancës në mbledhjen e të ardhurave si dhe mos efektiviteti i kontrollit të angazhimeve të shpenzimeve, ka bërë që institucionet buxhetore të gjenerojnë detyrime të prapambetura për kontratat e lidhura (detyrime për të cilat nuk ka një shifër të saktë,) faktorë të cilët përbëjnë rrezik për disiplinën fiskale.

Shpenzime kapitale, sikurse raportuar në Buxhetin Faktik, janë realizuar në masën 99.1% kundrejt planit, por në vlerë absolute shpenzimet për investimet, për vitin 2016 janë më të ultat në gjashtë vitet e fundit.


Në milionë lekë



Burimi. Ministria e Financave, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga një analizë më të detajuar në terma të realizimit mujor të shpenzimeve për investime, rezulton se pjesa më e madhe e investimeve kapitale është përqendruar në muajin dhjetor (34% e total investimeve).

Në milionë lekë




Burimi. Ministria e Financave, përpunuar nga grupi i auditimit

Përvec sa më sipër, nga auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, u konstatua se në llogaritë e investimeve për konstruksione të rrugëve; në ndërtesa shkollore dhe në objekte të tjera ndërtimore është përfshirë shlyerja e faturave për investime që i përkasin viteve të kaluara, fakt që ka rritur fiktivisht investimet e realizuara për periudhën objekt auditimi. Kështu janë konstatuar 107 raste në shumën 1,214,376 mijë (1.2 miliardë) lekë në transaksionet e ARRSH si dhe 44 raste në shumën 191,230 mijë (191 milionë) lekë në transaksionet e Bashkinë Tiranë.

Për gjatë vitit 2016, në 56 transaksione të ARRSH, në shumën 1,912,041 mijë (1.9 miliardë) lekë janë konstatuar fatura me variancë kohore nga data e faturës në datën e pagesës nga 32 ditë deri në 326 ditë. Ky fakt reflekton mospasqyrimin në kohë të faturave dhe mosmarrjen e masave nga ana e DPTH për disiplinimin e këtij procesi. Si pasojë e keqpërdorimit të fondeve në vitet e kaluara dhe përdorimit të buxhetit vjetor në shlyerjen e investimeve të periudhave të mëparshme, këtë vit sipas raportimeve të MF janë krijuar detyrime të reja të prapambetura në shumën 1,803 milionë lekë (1.8 miliardë lekë).

C. DEFICITI I PËRGJITHSHËM I BUXHETIT TË SHETIT

Deficiti i përgjithshëm i buxhetit të shtetit të vitit 2016, është ulur në masën 7,754 milionë lekë, ose 22.5%, kundrejt parashikimit, ndikuar nga mosrealizimi i të ardhurave buxhetore, ulja e shpenzimeve buxhetore por pa përjashtuar ndikimin e treguesve ekonomikë. Ky deficit përfaqëson 1.7% të PBB¹-së e përdorur në planifikim e vitit 2016, apo 1.8% e PBB faktike. Konstatohet se për vitin 2016 është respektuar rregull i artë i buxhetit sipas të cilit masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara, si në programim dhe në buxhetin e realizuar në nivel vjetor.



Burimi. Ministria e Financave, përpunuar nga grupi i auditimit

D. BORXHI PUBLIK DHE SHËRBIMI I BORXHIT

Borxhi Publik për vitin 2016 rezultoi në vlerën 1,066,566 milionë (1.07 triliardë) lekë me një rritje nga niveli prej 1,043,212 milionë (1.04 triliardë) lekë i realizuar për vitin 2015. Vlera relative e borxhit publik e raportuar është **71.01%** e PBB-së, por kjo mënyrë vlerësimi nuk është bazuar në vlerën më të fundit të PBB-së të raportuar në World Economic Outlook (Perspektiva ekonomike botërore), sikurse është përcaktuar në Ligjin, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në


¹PBB programuar në vlerën 1,530,465 milionë lekë

RSH”. Bazuar në këtë metodologji stoku i borxhit në fund të vitit 2016 rezulton **72.4% e PBB-së²**.

KLSH vlerëson se niveli i borxhit publik (si % kundrejt PBB) nuk tenton drejt parametrave të synuar, pasi për vitin 2015 niveli i borxhit publik është rritur në nivelin 72.71% (ose më saktë 73.06%), kurse për vitin 2016 niveli i borxhit publik ka arritur në 71.01% (ose më saktë 72.4%) dhe është larg përmbushjes së synimit të vendosur në Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020 për një nivel borxhi në fund të vitit 2017 në 65.5% të PBB-së, dhe larg objektivit prej 60% të PBB-së, që KLSH ka rekomanduar në pesë vite rresht, si nivel në të cilin duhet të luhatet Borxhi Publik. KLSH gjen rastin të ritheksojë se Qeveria duhet të angazhohet maksimalisht që të përmbushë objektivin e vendosur në këtë strategji për ta ulur borxhin publik nën 60% të PBB-së brenda një periudhe afatmesme.

Referuar strukturës së borxhit publik konstatohet se borxhi i brendshëm përbën 52.7% dhe borxhi i jashtëm zë 47.3% të stokut të borxhit në fund të vitit 2016. Borxhi i brendshëm rezultoi me një rritje me 1.73%, ndërsa ai i jashtëm rezultoi me një rritje me 2.7%. Në lidhje me borxhin publik, si një tregues i rëndësishëm, por dhe me ndjeshmëri në qëndrueshmërinë e financave publike dhe projeksionet ekonomike të së ardhmes, sjellim në vëmendje ekspozimin ndaj risqeve që krijon niveli i rritur i borxhit të jashtëm.

Në milionë lekë



² PBB-ja e raportuar në World Economic Outlook dhe e përdorur nga KLSH është e njëjtë me PBB-në e raportuar në tabelën e treguesve fiskal të Projekt Buxhetit 2018

Referuar treguesve fiskalë të paraqitur më lartë si dhe problematikave të evidentuara dhe të analizuara në mënyrë të detajuar në raportin e KLSH-së kemi rekomanduar:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të marrë të gjitha masat për përmirësimin e metodologjisë së përdorur për parashikimin dhe zbatimin e programit të të ardhurave buxhetore në mënyrë që të eliminojë devijimet e shumta ndërmjet të ardhurave të vlerësuara në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2016-2018 (Faza e parë) dhe të ardhurave të mbledhura nga Administrata Tatimore dhe Doganore.
- Realizimi i të ardhurave buxhetore kundrejt planifikimit, do të bëjë të mundur edhe një programim të mirë të shpenzimeve buxhetore si dhe do të ketë një rol kyç në plotësimin e nevojave të vendit, në përmirësimin e shërbimeve publike dhe njëkohësisht në rritjen e investimeve dhe nxitjen ekonomike. Në këtë mënyrë, **konsolidimi fiskal do të arrihet përmes rritjes së të ardhurave dhe jo me frenim të shpenzimeve publike.**
- Përmirësimi i menaxhimit të investimeve publike do të ndikonte në ruajtjen e qëndrueshmërisë ekonomike dhe mbajtjen nën kontroll të saj. Prioritet duhet të kenë investimet të cilat kanë ndikim të shpejtë në rritjen ekonomike, punësimin dhe uljen e varfërisë. Të gjitha këto për të mbajtur në nivelin e dëshiruar dhe të pranueshëm treguesit kryesorë në kontekstin e garantimit të konsolidimit fiskal.
- Të merret në konsideratë që në raportimin mbi raportin e borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto, vlera e cila do të përdoret për llogaritje e PBB të jetë konsistente dhe në bazë të një përcaktimi zyrtar të pandryshueshëm për kryerjen e analizave në të njëjtën bazë krahasuese dhe mos lënien e hapësirave për interpretim të këtij treguesi.

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë të evidentojë nevojat reale për huamarrje në realizimin e projekteve të reja të investimeve dhe të ketë raportim të ndarë për realizimin e investimeve të reja gjatë vitit buxhetor në mënyrë që të gjykohet në lidhje me përdorimin e shtesës së borxhit të marrë.
- Nga Ministria e Financave, të merren masa që veprimtaria e Sistemit të Thesarit, të ketë një kornizë ligjore, bazuar në rregulla të qarta dhe të mirëpërcaktuara, që mbështësin zhvillimet në sistemin e thesarit. Për shkak të rëndësisë që ka Thesari i Shtetit, natyrës specifike të tij dhe procesit kompleks të menaxhimit të financave të shtetit, të punohet, për një kuadër të plotë rregullativ në përputhje dhe me kërkesat e rregulloret e Bashkimit Europian, kjo edhe për të garantuar qëndrueshmërinë e këtij kuadri për një kohë të gjatë dhe të mos ndikohet nga situatat me të cilat ndeshet kjo Drejtori në aktivitetin e përditshëm dhe problematik të realitetit shqiptar.

<p>MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË ZHVILLIMIT TË RAJONEVE (FZHR)</p>

Nga auditimi, edhe për këtë vit, evidentohet mungesa e një kuadri rregullator të mire përcaktuar mbi FZHR, situatë që krijon hapësira për të shtuar nga qeveria “shtylla programore” me qëllim rritjen ose bërjen më fleksible të mundësive që i jepen për të anashkaluar kufizimet buxhetore dhe tejkaluar përcaktimet rregullatorë në drejtim të zbatimit të buxhetit vjetor. **Duke marrë në konsideratë problematikave të evidentuara dhe te analizuara në mënyrë të detajuar në raportin e KLSH-së, por edhe hapat pozitivë të ndërmarrë nga Ministria e Financave për ta përfshirë në kornizën buxhetore këtë fond, kemi rekomanduar:**

- Drejtoria e Financave Vendore, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të ngrejë një grup pune për instalimin e një database me të dhëna mbi financimin nga FZHR që nga krijimi e në

vazhdimësi me qëllim vlerësimin real të nevojave për likuidimin e detyrimeve të lindura në vite nga FZHR dhe krijimin e bazës për planifikimin sa më real të prioriteteve për të ndihmuar vendimmarrjen e KZHR në këtë drejtim. Mbajtja nën kontroll të nivelit të fondeve nën këtë zë tashmë të konsoliduar të buxhetit do ti shërbente monitorimit më të mirë të investimeve të realizuara nga ky zë.

MBI FONDIN E TË PËRNDJEKURVE POLITIKË

Në fund të vitit 2016, rezulton se për Fondin e të Përndjekurve Politikë, është shpenzuar vlera 2,000 milionë (2 miliardë) lekë, Fond ky i shpenzuar për 2 986 persona të kategorisë parësore dhe 3 544 persona të kategorisë Jo parësore. Nisur nga niveli mesatar i fondeve të lëvruara për çdo vit (2 miliardë lekë) si dhe vlera e fondeve të nevojshme (32,337 milionë (32.3 miliardë) lekë) për përfundimin e detyrimit financiar dhe veçanërisht moral që ka shteti ndaj kësaj kategorie (13 082 persona), për të përmbyllur këtë detyrim do të duhen rreth 16 vite të tjerë. Duhet të theksojmë se kjo shifër nuk është përfundimtare, pasi janë rreth 320 dosje të kategorisë parësore dhe rreth 24000 dosje të kategorisë jopaqësore të cilat presin për shqyrtim në rrugë administrative. Kjo problematikë lidhet me kuadrin ligjor por vjen edhe nga mbartja e problematikave nga migrimi i dosjeve të sistemit të vjetër të pagesave.

Përsa më sipër kemi rekomanduar:

- Të shtohen fondet vjetore që i kalojnë të përndjekurve politikë në mënyrë që të paguhen këto detyrime në kohë sa më të shpejtë. Të merren në analizë problematikat e adresuara dhe të jepet mundësia që zgjidhja e problematikave të jetë përmes vendimeve administrative të kësaj drejtorie duke synuar minimizimin e kostove në ngarkim të kësaj shtrese të popullsisë.

E gjykojmë të nevojshme ti kthehemi rekomandimit të dhënë më parë nga KLSH, që në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për

Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të përcaktohet që të ardhurat nga privatizimet në masën 20% të shkojnë për dëmshperblimin ligjor të ish të përndjekurve politikë, kjo për të përmbyllur në një kohë sa më të shpejtë këtë detyrim.

MBI PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË DHE FONDEVE TË KONTIGJENCËS

Nga auditimi i përdorimit të **Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit**, konstatohet se vijon problematika që një pjesë e konsiderueshme e fondit rezervë përdoret dhe alokohet në kundërshtim me udhëzimin standard të zbatimit të buxhetit të shtetit. Gjithashtu, mungon mënyra e llogaritjes së kostos për fondin e kërkuar, si dhe afatet e paraqitjes për mendim, para se të shqyrtohet në Këshillin e Ministrave.

Përsa më sipër kemi rekomanduar:

- Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të hartohet një kuadër i qartë rregullativ (rregullore apo udhëzues), mbi mënyrën e përdorimit, alokimit dhe raportimit të Fondit Rezervë, duke shmangur justifikimet lidhur me problematikën që vijojnë ndër vite.

Nga auditimi i përdorimit të **Fondit të Kontigjencës të Buxhetit të Shtetit**, konstatohet se vijon problematika që ky fond përdoret jo në përputhje me kriteret e përcaktuar në Ligjin organik të buxhetit. **Përsa më sipër kemi rekomanduar:**

- Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të bëhen ndërhyrjet e nevojshme ligjore në mënyrë që të mos ketë përkufizime të ndryshme në nivelet e ndryshme të hierarkisë ligjore, lidhur me përdorimin e Fondit të Kontigjencës.
- Të hartohet një kuadër i plotë rregullativ (rregullore apo udhëzues), mbi mënyrën e përdorimit, alokimit dhe raportimit të Fondit të Kontigjencës, për të shmangur problematikën e konstatuar lidhur me përdorimin e këtij fondi.


Në total efektet negative në buxhetin e vitit 2016 llogariten në vlerën **109,546 milionë (109.5 miliardë) lekë ose 820 milionë euro**. Në krahasim me vitin 2015 kjo shifër është rreth 53.3 miliardë lekë, ose 400 milionë euro, më e lartë.

Nga auditimet në zbatim të buxhetit 2016, KLSH ka konstatuar shkelje të ligjshmërisë financiare konsideruar si dëme ekonomike për buxhetin e shtetit në vlerën **19,909 milionë (19.9 miliardë) lekë ose 149 milionë euro**. Në krahasim me vitin 2015 kjo shifër është rreth 5 miliardë lekë, ose 37.5 milionë euro, më e lartë.

KLSH, ka konstatuar të ardhura të munguara apo shpenzime të realizuara, në kushtet e zbatimit jo korrekt të dispozitave ligjore në fuqi, në shkelje të parimeve të ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit me efekte negative për buxhetin e shtetit e vitit 2016 në vlerën 38,461 milionë (38.5 miliardë) lekë ose 288 milionë euro. Në krahasim me vitin 2015 kjo shifër është rreth 18.5 miliardë lekë, ose 138.5 milionë euro, më e lartë.

Si parashtruar edhe më lart, rritja e detyrimeve ndaj tatimeve dhe doganave (borxhi tatimor dhe doganor) si dhe skemës së sigurimeve shoqërore për vitin 2016 është në vlerë **51,175 milionë (52.2 miliardë) lekë ose 383 milionë euro** dhe përbën mungesë direkte të ardhurash për buxhetin e shtetit. Në vitin 2015 rritja e këtij borxhi ka qenë në vlerë 21.4 miliardë lekë.

Në milionë lekë



Burimi: KLSH

RAPORTIMI FINANCIAR NË SEKTORIN PUBLIK

Edhe për vitin 2016, Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, nuk janë pjesë e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit. Mungesa disavjeçare e pasqyrave të konsoliduara të shtetit në gjykim tonë ndikon jo vetëm në nivelin e transparencës, por është e lidhur ngushtë me analizën e treguesve makroekonomik. Konstatohet se nuk ka një bazë të qartë rregullative mbi të cilën realizohet Raportimi Financiar, fakt që krijon hapësira për mangësi të theksuara në mbajtjen e kontabilitetit dhe në raportimin financiar nga njësitë që duhet të raportojnë mbi bazë të standardeve të kontabilitetit publik. Pasqyrat financiare të hartuara përmbajnë gabime dhe nuk reflektojnë të gjitha transaksionet financiare të vitit. Përsa më sipër, si dhe problematikave të evidentuara dhe të analizuara në mënyrë të detajuar në raportin e KLSH-së **kemi rekomanduar:**

- Në kushtet kur ristrukturimi i qeverisë, prek edhe shkrirje, ndarje apo bashkime të institucioneve shtetërore, merr rëndësi nxjerrja e një udhëzimi që do të krijojë konsistencën me të cilin do të realizohet transferimi kontabël i aktiveve, të drejtave dhe detyrimeve nga një strukturë në tjetrën. Në mungesë të një veprimi të tillë procesi do të reflektojë konfuzion dhe pasaktësi të mëdha. Strukturat e Auditimit të Brendshëm të jenë të detyruar të

verifikojnë procesin e mbylljes së llogarive kontabël të institucioneve të shkrira apo të bashkuara.

- Ministri i Financave dhe Ekonomisë të publikojë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik IPSAS, si baza kryesore metodologjike mbi të cilën do të ndërtohet kontabiliteti publik në Shqipëri në të ardhmen e afërt. Publikimi i Standardeve që në këtë moment, do ti japë kohë përdoruesve (hartuesve të pasqyrave financiare), të njohin parimet mbi të cilët do të funksionojë kontabiliteti publik, menjëherë pas miratimit të Kuadrit të plotë regullativ në fushën e raportimit financiar në sektorin publik. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të realizojë një komunikim të hapur për të mbledhur opinione të pavarura dhe profesionale mbi domosdoshmërinë e ligjit “Për Kontabilitetin Publik”.

MBI AUDITIMIN E BRENDSHËM PUBLIK

Auditimi i brendshëm ka njohur zhvillime të rëndësishme, por që mbeten akoma në nivelin e përgatitjes të dokumenteve bazë dhe ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve profesionale audituese, larg marrjes së rezultateve konkrete të përmirësuar dhe të pritshme nga funksioni i auditimit të brendshëm në njësitë e sektorit publik. Pavarësia funksionale e auditimit të brendshëm nuk është siguruar plotësisht. Ndonëse janë bërë hapa në drejtim të ndarjes së strukturave dhe veçimit të veprimtarisë së auditimit nga veprimtaritë e tjera të njësisve publike, raportimi te niveli më i lartë i menaxhimit, ndjekja e rekomandimeve, duhen përmirësuar më tej.

Lidhur me ngritjen dhe funksionimin e Komiteteve të Auditimit, kemi konstatuar se duke qënë se ngritja e këtyre strukturave është lënë në diskrecion të Titullarit të Institucionit funksionimi i këtyre komiteteve ka qënë i segmentuar, pasi janë krijuar vetëm në 8 nga 16 ministri. Nuk ka një procedurë të mirë përcaktuar mbi vlerësimin e profesionalizmit dhe kapaciteteve që do përfshihen në këto Komitete duke reflektuar kështu një nivel risku të lartë operacional. Edhe ato raste kur këto Komitete janë krijuar, ka përsëritje të ekspertëve të

përfshirë në to, gjë që reflekton potencialisht mungesën e kapaciteteve për të siguruar një mision të plotë në dhënien e garancive të arsyeshme lidhur me procesin.

Konstatohet se mungon koordinimi dhe monitorimi i veprimtarive të Komiteteve të Auditimit, pasi Struktura e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk ka asnjë informacion lidhur me aktivitetin e punës së këtyre strukturave në institucionet që janë ngritur. Përsa më sipër si dhe problematikave të evidentuara dhe të analizuara në mënyrë të detajuar në raportin e KLSH-së **kemi rekomanduar:**

Me qëllim që të sigurohet mirëfunksionimi i Komiteteve të Auditimit si organe këshilluese pranë titullarit, si një hallkë shtesë për rritjen e pavarësisë funksionale të strukturave të auditimit të brendshëm, **të rishikohet VKM** mbi të cilin ngrihen, funksionojnë dhe raportojnë Komitete të Auditimit, duke adresuar me kujdes problematikat e konstatuara. Vëmendje të shtuar duhet të ketë deklarimi i konfliktit të interesit që cenon objektivitetin e këtyre strukturave.

Strukturat e Auditimit të Brendshëm, për vitin 2016 kanë planifikuar 1637 auditime ose 252 objekte më pak se ato të planifikuara për vitin 2015. Konstatohet se janë realizuar 1361 auditime gjithsej, nga të cilat, auditime të plota janë kryer 626 ose 46% të totalit, auditime financiare 116 ose 8.5%, auditime të përputhshmërisë 356 ose 26%, auditime performance 77 ose 5.7% të totalit. Në nivel Ministrish, rezulton se strukturat kanë planifikuar 389 misione auditimi dhe kanë realizuar 394 misione auditimi nga të cilat 93 misione ndjekje rekomandimesh. Në këtë rast, përfshirja e zbatimit të rekomandimeve në numrin e auditimeve të realizuara jep një pamje të deformuar të realizimit të planit, kjo për sa kohë që auditimi i zbatimit të rekomandimeve nuk është parashikuar në planin vjetor.

Nga të dhënat u konstatua se mbetet problematika që në strukturat e Auditimit të Brendshëm ka persona të pa certifikuar dhe kjo situatë (e pranishme më shumë në organet e pushtetit vendor dhe njësitë e

varësisë) cënon arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit të brendshëm. Niveli i njëjtë i personave të pa certifikuar në sistem, tregon se strukturat kanë lëvizje të vazhdueshme të stafit dhe nga Titullarët nuk i kushtohet vëmendje e veçantë kritereve që duhet të plotësohen, në mënyrë që të garantohet cilësia e auditimeve.

Nga auditimet e kryera janë konstatuar 9,421 raste të shkeljeve, me impakt negativ në **2,111 milionë (2.1 miliardë) lekë**. Për vitin 2016 ka ndryshuar formati i raportimit e klasifikimit të sistemeve dhe është e pamundur të bëhet analiza krahasuese sipas sistemeve. Konstatohet se 2016 ka nivelin më të ulët të gjetjeve me efekt negative, kjo nisur edhe nga roli i ri (vetëm këshillimor) që përkufizon ligji për strukturat e auditimit të brendshëm.

Të dhënat e raportuara, tregojnë se shkeljet me efekte negative në buxhet në masën 38% i takojnë grupimit “të tjera”, fakt që tregon se gjetjet nuk i takojnë sistemeve të vlerësuara me nivel të lartë apo të mesëm të riskut, pasuar me nivelin 20% gjetjet në “sistemin tatime dhe dogana”, 12% i takojnë gjetjeve në sistemin “administrim prone, pasurie” dhe me 11% vijnë gjetjet nga sistemi “paga, shpërblime kompensime”. Megjithëse zona me risk më të lartë në administrimin e fondeve buxhetore është ajo e prokurimeve, nga strukturat e auditimit të brendshëm gjetjet e këtij sistemi janë vetëm 9%. Strukturat raportojnë të dhëna në numër dhe vlerë për parregullsitë me ndikim financiar sipas sistemeve, *por pa cilësuar se, sa nga vlera e gjetjeve përbën dëm ekonomik për fondet publike, dhe për sa prej tyre është kërkuar kthimi i shumave në buxhetin e shteti.*

Është konstatuar, *nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve me 47%, pavarësisht se pranueshmëria e tyre është në masën 99%. Konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve në nivel ministrish është 22% ndërkohë që në pushtetin vendor ky nivel zbatimi rritet në 29%. Niveli i ulët apo, niveli zero i zbatimit të rekomandimeve në disa subjekte, tregon se nga Titullarët e Institucioneve akoma nuk është kuptuar rëndësia e zbatimit të rekomandimeve të Auditimit të Brendshëm. Neglizhenca e konstatuar tregon akoma varësinë që këto struktura*

kanë nga titullarët dhe pamundësinë në këto kushte për të shtuar presionin për zbatimin e rekomandimeve.

Kemi rekomanduar që strukturat e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë të marrin një rol më aktiv në monitorimin e strukturave të Auditimit të Brendshëm dhe realizimin e misionit të tyre.

MBI MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN

Kemi konstatuar devijime në funksionimin e strukturave që monitorojnë vendosjen e sistemeve të kontrollit dhe sigurojnë që institucionet njohin dhe implementojnë kërkesat për një kornizë të menaxhimit financiar dhe kontrollit funksionale. Struktura përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe kontrollin nuk ka arritur të vendosë një urë komunikimi të përshtatshme me institucionet publike për të udhëhequr nga pikëpamja metodologjike këtë proces, jo vetëm të vështirë, por edhe sfidues. Konstatohet se përzgjedhja e personave në borde dhe komitete, në mbështetje të strukturave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është realizuar jo në përputhje me kriteret dhe në disa raste konflikti i interesave ka ekspozuar vendimmarrjen ndaj riskut operacional. Përsa më sipër, si dhe problematikave të evidentuara dhe të analizuara në mënyrë të detajuar në raportin e KLSH-së kemi rekomanduar:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa me qëllim ripërkufizimin e fushës së zbatimit të ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ...duke u shprehur në këtë kuadër ligjor për përfshirjen në fushën e zbatimit të tij edhe të institucioneve të pavarura të cilat krijojnë apo shpenzojnë fonde publike.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë të rishikojë organizimin dhe funksionimin e Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, me qëllim kthimin e tij në një strukturë që i shërben përmirësimit të menaxhimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në shkallë vendi, duke synuar një pjesëmarrje më të reduktuar por më efektive dhe veçanërisht këshilluese në fushën e kontrollit.

- Të rishikohen treguesit e vlerësimit të performancës, për të qenë më përfaqësues dhe dhënë një pamje të drejtë të funksionimit të sistemit të auditit të brendshëm dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm në sektorin publik. (tregues të përcaktuar në Urdhrin e Monitorimit të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015)

MBI AUDITIMIN E FONDEVE TË SHPENZUARA NGA NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

Konstatohet se përveç impakteve pozitive që ka dhënë në drejtim të përqendrimit dhe kontrollit më të mirë të të ardhurave, rritjes së volumit të investimeve dhe kontrollit të aseteve, në opinionin tonë të pavarur, edhe në vitin e dytë të zbatimit të saj, nuk kanë arritur pritshmëritë në lidhje me rritjen dhe cilësinë e shërbimeve ndaj komunitetit, rritjen e të ardhurave financiare dhe konsolidimit fiskal, etj. Problematikat e konstatuara nga administrimi i këtyre njësive të vetëqeverisjes vendore:

Nivel i ulët i të ardhurave të mbledhura. Në 21 subjektet e audituara niveli i borxhit tatimor paraqitet në vlerën 1,338 milionë lekë, i cili ka ardhur gjithmonë në rritje nga viti në vit, duke reflektuar nivelin e lartë të të ardhurave të munguara në buxhetet e këtyre njësive. *Pavarësisht se disa herë kanë dalë akte ligjore për faljen e taksave dhe tarifave vendore, përsëri niveli i borxhit tatimor paraqitet në rritje, kjo edhe për faktin se kalimi i aktivitetit të subjekteve nga ish komunat në bashki, listat apo dosjet e bizneseve, nuk është bërë në kujdesin e duhur dhe bazuar në kërkesat ligjore.*

Detyrime të prapambetura të nivelit shqetësues. Nga auditimet e ushtruara, rezulton se në mjaft njësi të vetëqeverisjes vendore, është *akumuluar një borxh i konsiderueshëm, nëpërmjet krijimit të faturave të palikujduara ndër vite, për arsye të kryerjes së punimeve apo shërbimeve pa u siguruar më parë fondet e nevojshme për kryerjen e tyre.*

Kontrolli dhe administrimi i territorit nga njësiti e vetëqeverisjes vendore. Edhe pse Njësive të Vetëqeverisje Vendore ju janë *transferuar* pjesa më e madhe e pronave, kullotave dhe pyjeve, ende nuk janë kryer inventarizimet dhe regjistrimet në zyrat e regjistrimit (ZVRPP), me justifikimin e mungesës së hartave përkatëse. Për kontrollin e territorit në pjesën më të madhe të bashkive janë krijuar dhe funksionojnë strukturat e Inspektorateve të Mbrojtjes Territorit (IMTV), por këto struktura nuk janë plotësuar me specialistë të fushës, fakt që shton riskun operacionalnë përmbushje të misionit të tyre.

Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin. Nuk njihen dhe nuk funksionojnë sistemet e kontrollit të brendshëm, fakt që reflekton nivel të ulët të efektivitetit dhe efikasitetit në shpenzimin e fondeve në dispozicion.

Duke patur në konsideratë rendësinë, sfidat e reformës territoriale si dhe problematikat e evidentuara më lart në lidhje me administrimin e njësive vendore, në mënyrë që të ketë një qasje më të dokumentuar lidhur me ecurinë e reformës territoriale, KLSH do të kryejë një auditim performance gjatë vitit 2018.

SKEMA E SIGURIMEVE SHOQËRORE

Realizimi i shpenzimeve gjithsej për vitin 2016 është në vlerë 114,276 milionë (114.3 miliardë) lekë ose 98.8% krahasuar me planin e ndryshuar. Për vitin 2016 të ardhurat mbulojnë vetëm 58% të shpenzimeve me një përmirësim nga një vit më parë kur vlera ishte 56%. Në fund të vitit 2016 të ardhurat nga dega e pensionit të qytetit mbulojnë 80.7% të shpenzimeve të kësaj dege, në krahasim me 77.7% një vit më parë. Në fund të vitit 2016 të ardhurat nga dega e pensionit të fshatit mbulojnë vetëm 22% të shpenzimeve të kësaj dege, në krahasim me 28% një vit më parë. Për këtë arsye, **i kemi rekomanduar** strukturave drejtuese të ISSH të kryejnë studime të

mirëfillta e të veçanta për degën e pensioneve të fshatit për të minimizuar defiçitin e kësaj skeme.

SKEMA E SIGURIMEVE TE DETYRUESHME TË KUJDESIT SHËNDETSOR

Në lidhje me skemën e sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor, shpenzimet faktike gjatë vitit 2016 janë 34,796 milionë (34.8 miliardë) lekë dhe në krahasim me faktin e vitit 2015 janë rritur me 7%.

Shpenzimet për rimbursimin e barnave për vitin 2016 janë realizuar në masën 98,8% e programimit.

Financimet për shërbimin spitalor ndërmjet thesarit, parashikohet në ligjin e buxhetit dhe miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Shpenzimet për shërbimin spitalor nëpërmjet thesarit përbëjnë 48.5% të buxhetit të FSDKSH për vitin 2016. Këto shpenzime janë realizuar në masën 98.3% kundrejt planit.

Shpenzimet për Shërbimin e Kujdesit Shëndetësor Parësor janë realizuar në masën 95.3% e programimit vjetor. Në këtë zë përfshihen dhe 803 milionë lekë për likuidimin e faturave të shërbimit të kontrollit bazë shëndetësor të popullsisë nga 35-70 vjeç.

Nga auditimi në FSDKSH, përveç efekteve negative për buxhetin e shtetit të përlogaritura në rreth 1.8 miliardë lekë, në gjykimin e pavarur profesional të KLSH vlerësojmë se FSDKSH nuk ka një sistem të kontrollit të brendshëm efektiv për të garantuar përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë aktivitetin e institucionit.

MBI CËNIMIN E TË DREJTËS SË KLSH PËR TË USHTRUAR MANDATIN E TIJ, NË SH.A. DHE ENTE RREGULLATORE

Gjatë vitit 2016, në ushtrimin e mandatit tonë, kemi ndeshur në raste të cenimit të rëndë të mandatit tonë kushtetues për të audituar fondet publike, sjellje që janë në kundërshtim me nenet 162-165 të

Kushtetutës, si dhe me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Kështu:

Dy auditime të iniciuar në Entin Rregullator të Energjisë nuk janë lejuar të zhvillohen nga Kryetari i ERE-së, me pretendimin se ERE është një Person Juridik Publik, i pavarur nga çdo institucion tjetër publik ose privat, dhe jashtë juridiksionit auditues të KLSH.

Gjithashtu auditimi i iniciuar në shoqërinë Albpetrol sh.a me objekt auditimin e 3-mujorit të fundit të vitit 2016, për plotësimin e gjetjeve për vitin 2016, si dhe të riverifikimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm për 9-mujorin e vitit 2016, me qëllim përfshirjen në Raportin e Buxhetit Faktik 2016, është vonuar si pasojë e pengesave dhe refuzimit nga administratori i kësaj shoqërie. KLSH ka mundur të rifillojë auditimin në shoqërinë Albpetrol sh.a, në muajin Shtator 2017, falë ndërhyrjes dhe bashkëpunimit të Ministrit të MEI-it, i cili ka mbajtur një qëndrim korrekt dhe në mbështetje të së drejtës Kushtetuese dhe ligjore të KLSH-së për të zhvilluar misionin auditues.

MBI PROKURIMIN PUBLIK

Konstatohet se për vitin 2016, nga totali i shpenzimeve të buxhetit prej 148,573 milionë (148.6 miliardë) lekë vetëm 60% e totalit është prokuruar gjatë vitit 2016 (87,372 milionë lekë). Dimë që lloji i procedrës së ndjekur ndikon drejtpërsëdrejti në nxitjen e konkurrencës dhe pjesmarrjen e Opeatorëve Ekonomik (OE) dhe rrjedhimisht në transparencë dhe besueshmëri të procesit të realizuar për shpenzimin e fondeve publike. Konstatohet se vetëm 41% e numrit të procedurave është realizuar me “Tender i hapur lokal”, ndërsa 59% e numrit të procedurave është realizuar me procedurën “Kerkese per propozim”, pavarësisht se si nivel fondi të prokuruar këto të fundit, zënë vetëm 7% të fondit të hedhur në prokurim për vitin 2016.

Procedura e prokurimit publik “*Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës*” përbën rreth 30% të numrit praktikave të prokurimit gjithsej realizuara për vitin 2016. Kjo lloj procedure nuk kryhet nëpërmjet sistemit elektronik si dhe nuk kërkon njoftim publik, pra niveli fondeve të prokuruar nën këtë procedurë nuk është në nivelin e transparencës së procedurave të tjera. Gjatë vitit 2016 dhe në vijim të 2017, KLSH ka realizuar edhe një auditim performance me temë “Procedurat e Prokurimit Publik në Shqipëri”, i cili u përqendrua në procedurën e prokurimit “negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”.

Procedurat e prokurimit publik “*negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës*”, janë “stimuluar” duke krijuar situata “emergjente” sepse aktet ligjore për zbatimin e buxhetit nuk lejojnë fillimin e një procedure prokurimi në rast se nuk ka kaluar buxheti përkatës ose legjislacioni nuk është plotësisht i harmonizuar me legjislacionin e menaxhim financiar; për shkak të tejkalimit të afateve në shqyrtimin e ankesave dhe të procedurave burokratike; organizimit procedurave të prokurimit publik nga një dorë e vetme për disa mallra e shërbime. Legjislacioni shqiptar në këtë aspekt të prokurimit nuk është plotësisht në linjë me acquis-në e Bashkimit Evropian në këtë fushë; nuk ka një udhëzim specifik i cili të pasqyrojë në mënyrë më të detajuar dhe të hollësishme hapat, afatet dhe veprimet që duhet të zbatojnë Autoritetet Kontraktore në rastin e përdorimit të procedurës prokurimit publik “*negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës*”. Në këtë kontekst kemi kërkuar vëmendje në monitorim por edhe ndërhyrje në legjislacion për të minimizuar rastet emergjente "fiktive" të raportuara nga autoritetet kontraktuale. Është i nevojshëm promovimi i përdorimit të sistemit elektronik të prokurimit publik për procedurën e negociuar me qëllim rritjen e transparencës. Nga auditimi kemi konstatuar se kjo lloj procedure nuk është monitoruar sa duhet.

Në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara janë shpallur fitues 1140 operatorë ekonomikë për 5067 procedura prokurimi në total.

Janë kryer teste të përqëndrimit dhe nga analiza e bazës së të dhënave në lidhje me prokurimet e fituara evidentohet që gjatë vitit 2016, 50% e vlerës totale të prokuruar është përfituar nga 57 operatorë ekonomikë ose 5 % e totalit të operatorëve të cilët kanë fituar 14.7% prokurime nga totali i atyre të zhvilluara.

Të dhënat³ tregojnë se 10% të numrit total të prokurimeve zhvillohen nga 10 autoritete kontraktore të cilat përdorën 41 % e fondeve të prokuruarra për vitin 2016. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ka vlerën më të lartë të fondeve të prokuruarra në nivelin 11.5 miliardë lekë, pasuar nga DPP (Drejtoria e Prokurimeve të Përqëndruara në Ministrinë e Punëve të Brëndshme) me 4.1 miliardë lekë, Bashkia Tiranë me 3.7 miliard lekë dhe KESH 3.7 miliard lekë.

Të nderuar zonja dhe zotërinj në respekt të kohës së përcaktuar ky prezantim u fokusua në Treguesit Kryesorë të Buxhetit Faktik dhe në dhënien e disa rekomandimeve që synojnë minimizimin e risqeve që kërcënojnë financave publike në vend.

KLSH do të vazhdojë të jetë një zë i pavarur, duke theksuar aspektet që kanë nevojë për përmirësim dhe duke hedhur dritë mbi fakte që i kushtojnë shumë jo vetëm buxhetit vjetor por ndikojnë në të ardhmen zhvillimin ekonomik, për të cilat vëmendja juaj duhet të jetë maksimale.

KLSH në mënyrë konsistente shpesh vullnetin dhe gadishmërinë për të qënë pjesë aktive e seancave dëgjimore që ky komision i nderuar mund të organizojë për tematika apo subjekte të vecantë.

³Burimi : Agjencia e Prokurimit Publik